REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. 16573/5 **Prot.** **Lezhë, më** 24/09/**2026**

PROCES VERBAL

Titulli i projektaktit:Konsultim Publik për ndryshimin e Tarifës së Kopshteve në Bashkinë Lezhë
Datat dhe vendi i mbajtjes së takimit :24/09/2026,ora 10:00 pranë Bibliotekës "Gjergj Fishta"Lezhë

Pjesmarrësit në takim nga ana e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore : 1-Eueda Molla –Nënkryetare në Bashkinë Lezhë. 2-Aurora Gjeloshi –Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve 3-Florida Çunaj -Sekretare e Keshillit Bashkiak. 4-Uendi Gjoka –Përgjegjëse e Arsimi Parashkollor 5-Ornela Simoni-Specialiste e Arsimit Parashkollor 6-Denisa Nikolli –Specialist Psikologe
Territori që mbulon Konsultimi Publik: Bashkia Lezhë
Numri i Përsonave që marrin pjesë në takim:50 përsona Nr i femrave që marrin pjesë në takim: 45 përsona
-Znj Eueda Molla - Nënkryetare në Bashkinë Lezhë- Përshëndetje të gjithëve! Dhe prandaj sot e e kemi organizuar këtë dëgjese që të marrim dhe të japim informacione, konsultime, të bëjme diçka më mirë, të na thoni ku ta ndryshojmë, ku ta rregullojmë, domethenë të jemi të gjithë që kur të shkojme në projekt-vendim kjo tarife e re ne të jemi të gjithë të njetrajtshëm, të kemi të gjithë të njejtin mendim. Kshuqe dua që sot ky takim të jetë dhe si bashkëbisedim që gjithësecili të jap atë mendim që mendon ai. Ne absolutisht jemi përballë këtij fakti që kemi ardh sot këtu për ta ngritur këtë çmim për faktin e vetëm që gjatë 5 viteve të fundit nuk ka ndryshuar tarifa e kopshteve edhe pse është rritur çmimi i tregut të produkteve, ne përsëri nuk e kemi rritur. Jemi sot në faktin që kemi një debit të madhe kundrejtë kostos së shërbimit që ne ofrojm dhe kostove të ushqimit. Nuk është një rritje e madhe nga 170 lekë në ditë që ka qënë për fëmijë shkon tek 220 lekë në dite për fëmijë. Nëse fëmija frekuenton 22 ditët prindëri paguan në fund të muajit 4840 ndërkohë që deri tani ka paguar rreth 3740 lekë. Kostoja shtesë është tek 1100 lekë nëse femija i frekuenton 22 ditët. Nëse prindëri lajmëron të paktën 1 ditë më përpara që femija nuk do të vijë, atëherë ai nuk do të paguaj në tarifë. Diçka tjetër që do e

keni parë në web, është analiza që është bërë për gjatë viteve për rezultat të mbledhjeve të këtyre tarifave. Ne jemi përball faktit që çdo vit po e thellojmë këtë debi sepse ndoshta është dhe mangësi nga ana jonë sepse nuk kemi arritur të mbledhim të gjitha tarifat në fund të muajit nga secili prind. Dhe është një pikë tjetër e projekt-vendimit për masat që do marrim për ta mbledhur këtë tarifë. Tjetër që dua të diskutoj është dhe fakti që ne kemi ardhur këtu për marrjen e këtij vendimi dhe si pasojë e rritjes së kërkeses së vazhdueshme për akomodimin e fëmijeve. Ne sot në kopshtet e qytetit kemi diku afro 703 fëmijë, që jane diku tek 553 fëmijë janë me fjetje dhe 150 janë pa fjetje, kjo është dhe një rëndese më e madhe për koston e sherbimit. Dua të theksoj që në koston që prindi do të paguaj është vetëm pjesa e kostos së ushqimit. Nuk janë absolutisht pagesat e tjera që ne kryejmë sic shte ana infrastrukturore që është e drejta e bashkise ta kryej. Janë blerjet e tjera, mirembajtjet, mjetet didaktike janë gjëra që unë nuk dua ti permend tani sepse gjithsecili e di mirembajtjen që bëhet në kopshte dhe dua të them ndoshta me krenari që ndoshta kjo rritje e kërkeses së prindërve e vazhdueshme është falë sherbimeit të mire që japin edukatoret cdo ditë dhe dua ti falenderoj të gjithë për punën e mire që bëjnë sepse ato në fakt janë pasqyra e punës që rritet kërkesa e këtyre fëmijeve. Dhe nuk më ngelet tjetër por ti jap fjalën Drejtoreshës së Arsimit të Bashkisë ta shpjegojë më me detaje për marrjen e masave te ketij projekt vendimi.

-Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve – Faleminderit të gjithëve që jeni këtu! Unë në të vërtet e prisja pjesëmarrjen por jo dhe kaq shumë çka do të thotë që gjitha masat që ne marrim na prekin drejtpërdrejt dhe ne jemi të gjithë bashkë koshient si prindër në rrallë të parë pastaj si funksionar të institucioneve tona që është shumë e rëndësishme që herë pas here, e para të ristrukturojmë dhe te rianalizojmë veten. Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të cilësisë së shërbimit jemi të detyruar të marrim masa të cilat jo domosdoshmërisht duken sikur pranohen por është e rëndësishme që të gjithë të dimë që është një shërbim në shërbim të cilësisë së jetës që fëmijët tanë kanë. Kopshtet e qytetit janë gjithmonë me kërkesa në rritje, në projekt-vendim kemi vënë edhe shifra pra jemi nga 2023 që kemi patur 476 fëmijë të akomoduar me fjetje dhe me ushqim, mbas tre vitetve ne jemi me një numer gati 570 ky numer është fokusuar sepse ne kemi ambjente të kufizuara. Këtë vit unë i kam ndjekur personalisht të gjithë regjistrimet për kopshte, nëse ju keni qënë prind që keni regjistruar për herë të parë e keni kuptuar shumë mirë që këtë vit ka ndryshu procesi sepse ne si Drejtori dhe si Bashki jemi futur në detaje për të analizuar të gjithë aplikimet që prindërit kanë bërë. E dini pse ndodh kjo? Ndodh që vit pas viti kërkesat janë të papërballueshme dhe ne gjendemi përpara dy faktesh të cilat duhet ti barazpeshojmë. Ne vërtet si Bashki kemi detyrimin që ti akomodojmë fëmijët e qytetit, por në asnjë moment nuk mund ta ulim cilësinë, ne nuk mund të rrisism pa karar numrin e fëmijëve që janë nëpër grupe. Jemi në kërkim të vazhdueshem të ambjenteve të reja që ta përballojmë akomodimin për më shumë fëmijë nuk është një shërbim që mund ta shohim brenda vitit. Ajo që ka ndodhur është se të pakten 5 vitet e fundit nuk e kemi pasqyruar as inflacionin për rritjen e çmimit të produkteve, asnjë shërbim që është bërë shtesë për femijet tanë nuk e kemi pasqyruar në rritjen e çmimit, fëmijët e kopshtetve kanë paguar të njëjten kosto. Në vitin 2024 kontrata për ushqim pra shpenzimi i bashkisë për ushqimet ka qenë 9,500,000 lekë. Në 2025 u bë 10,000,000 lekë. Në 2026 12,000,000 lekë. Dhe jemi duke tentuar ta rrisim prap me 20% të tjera vitin që vjen. Çfarë do të thotë, kjo rritje duhet të pasqyrohet patjeter dhe referuar ligjit për vjeljen e tarifave. Duhet të pasqyrohet në vjeljen e taksave në Bashki. Duhet të theksojmë që ne nuk jemi duke e rritur cmimin, jemi duke barazuar çmimin që prindërit paguajnë me cmimin aktual të tregut. Këtë duhet ta kishim bërë vite me përapara por për shume arsye nuk ka ndodhur. Një nga pikat

e tjera që është shume e rendesishme dhe ndoshta që ndikon në vendimin qe ne marrim është nje ristrukturim i brendshem i mënyrës sesi ne funksionojm, pra ne deri tani ushqejme 570 fëmije në ditë. Ne asnjë mënyre nuk duam që kjo të ndikojë negativisht në ekonomin e familjeve në Lezhë por ne duhet të ndërgjegjësohemi se persa kohe kemi lëne driten e syve në keto kopshte duhet të mbajmë pergjegjësit që duhet. Kjo është një nga arsyet kryesore që kemi venë rregullin që nese nuk njoftojm 1 dite para për mungesen e fëmijeve, pra deri në oren 4 për mungesat e planifikuara po flas. Atëhere prindi duhet ta dije që në momentin që ky femijë nuk ka njoftuar qe mungon Drejtoresha e kopshtit duhet ta dije një dite përpara sa femijë ka neser për të ushqyer. Ne momentin qe ky prind nuk njofton dita do ti konsiderohet e paguar. E dyta cfare na ndodh, mua me vijne listeprezancat e fëmijeve, kam nje grup me 30 femije ku 5 nga ato femije e kanë 0 frekuentimin pa pike arsye. Ndërkohe që unë kam lene 10 femije në pritje për ti akomoduar me fjetje, domethene janë 20 prindër që duhet të kufizohen për punën e tyre sepse nuk kanë ku akomodojnë fëmijët në kopshte. Me një kerkese kaq të madhe qe kemi nuk do ta lejojme me. Ne momentin që ky femije nuk njofton dhe nuk frekuenton më shume se 50% te kohës pa arsye dhe pa raport mjeksor, dhe nuk njofton me shume se 1 muaj, regjistrimi do te zhbëhet, pra ky fëmije nuk duhet të zerë vendim, do të kete vend ndoshta pa drek dhe pa gjumë ama krevatin e nje femijeje tjeter dhe komoditetin e një familjeje tjeter nuk mund ta zej një fëmije tjeter që nuk vjen. Ne kemi me shume 20% në muaj debitore. Për këte arsye duke filluar nga ky vit ne do të shtojme në paketen fiskale, parapagimin. Të gjithë femijet që regjistrohen për herë të parë, pra 3 vjec, do të paguajnë në shtator një muaj të plote të parapagimit që do të konsiderohet parapagim i muajit të fundit të gushtit kur fëmija përfundon kopshtin. I vetmi problem është se në ketë muaj jemi vonë, pra ne duhet ta kishim bërë mbledhjen në gusht por për shkak të pushimeve do të kishim pjesëmarrje të vogël. Ama do të duhet të bëjmë njoftim prindërit që janë regjistruar për herë të parë që pagesa të bëhet. Ne si Drejtori kemi prioritet të ofrojmë shërbimin më cilësor. Nëse ka pyetje për të gjitha sa folëm, mendojmë t'i bëjmë tani dhe nëse ka gjëra shtesë për aq sa folëm.

-Prindi nr 1- Përshëndetje kam fëmijë të Kopshti lagjes Skëndërbeg, kopshti në tranzicion duke u rregulluar .Pjesa ekonomike.Numri fëmijëve është rrit dhe janë shumë pak të ardhura. A keni menduar për prindërit që nuk kanë mundësi ekonomike?

-Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Paga minimale këto vitë është rritur prap. Pagat nuk rregullohen nga Bashkia .Ti nuk do të faturohesh për fëmijët e tjerë. Nëse ju nuk do lajmëroni Drejtoreshën do paguani për ditët që keni qëndruar. Nëse sëmuret fëmija do paguash vec ditën e pare, për ditë tjera lajmëron humb vec një ditë që është zgjuar me temperature.

-Prindi nr 2-Shtretërit janë shumë të vegjël.

- Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve – Krevatet janë masa standarte, vijn nga Ministria, nuk i përshtasim dot krevatet për fëmijët.

-Eva Ndreu-Drejtoreshe e Kopshtit "Beselidhja"- sikurse është në dijeni dhe Bashkia, është një ngarkesa shumë e madhe, kërkesa për akomodimin e fëmijëve është goxha e madhe. Unë para se me qënë Dejtuese kam qënë vetë mësuese kam punuar në privat dhe në shtet si mësusese, duhet me ndjek pak dhe ngarkesën që kanë dhe mësuesit. Duket pak e vështirë të rakordojnë për pjësën e mungesave. Po sikur telefoni mos funksionoj, mos të punoj, prindi do thotë unë kam njoftu. Telefoni normalisht është privat nuk është një telefon i kopshtit. Mësuesit vetë të japin fjalën e tyre në lidhje me ketë situatë.

-Znj Eueda Molla - Nënkryetare në Bashkinë Lezhë-me fal Eva tek grupet që keni me prindërit a je dhe aty? Njoftimin e merr edhe ti.dhe ti komunikon me kuzhinieren pse të jetë një pjese e shtuar për edukatoret..

-Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Unë mendoj se sidomos me Drejtuesit ne kemi bërë takime disa herë dhe e kemi shtjelluar derisa dolëm në projekt vendim. Idenë unë nuk e kam si urdhër se kështu do bëhet dhe pikë. Dhe mënyra më e mirë është kjo qe të mos sikletosim të gjithë njerëzit për cdo gjë të shkruhet në grupe nëse nuk e merr edukatorja do ta marrë Drejtoresha. Ai grup në fund të muajit do sjell listëprezencen nuk e merr vesh sot do merret vesh nesër pra nuk po i fusim në burg njerëzit jemi duke diskutuar që ti të jesh rregullatore në grupe dhe ky informacion të shkoj në kohën e duhur. Nëse një ditë nuk u mor vesh dhe nuk u rregjistru nuk do falimentoj sistemi arsimor, pra ideja është kjo që juve të mund të sidomos tani që është muaji parë e do jetë, nuk po them test po muajt e parë do ketë gjithmonë probleme edhe përshtatje nga ana prinderve do kenë nevojë nga ana tjetër dhe përshtatje nga edukatorët dhe ju që jeni rregullatorët kryesore nëpër kopshte. Unë nuk e pranoj dot se vjen nga ti se ti duhet të jesh rregullatore.
-Znj Eva Ndreu-Drejtoreshe e Kopshtit "Beselidhja- Nuk vjen nga unë si kopsht po ne më mirë e diskutojmë se mësuesit do mbajnë përgjegjësi për aq ditë ngrënie, sot jemi në kushte të tilla se në arsimin parashkollor nuk ka regjistra imagjino, shkollat a kanë snipe kanë heq regjistrat kopshtet nuk kanë as snipe as regjistra.
-Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Ku i mbani ju listprezencat deri tani?
-Znj Eva Ndreu-Drejtoreshe e Kopshtit "Beselidhja- Në regjistrat i kemi formuar vetë.
-Znj Aurora Gjeloshi– Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve -Shumë mire dhe ti e shkrunan se ky fëmijë ka ardhur 10 ditë, 2 nga të cilat i ka mungesë pa arsye, 8 me arsye do të thotë ky fëmijë do të faturohet për 10 ditët që ka qënë 2 ditë që nuk ka njoftuar por në të vërtetë ka munguar 12 ditë dhe 10 ditë nuk faturohet se ka njoftuar dhe është brenda rregullave. Ju në listëprezencën që sillni tek ne për të bërë pagesën dhe për të llogaritur pagesën bëni një kolonë shtesë që është ajo pa arsye. Nëse keni nevojë nga Drejtoria ju vejmë në dizpozicion një tabelë të re që mban bëjmë një exel të ri. Nëse është e nevojshme që të porosisim nga një regjistër në vit për 5 kopshte që po flasim i porosisim jua sjellim që nesër. Jam e hapur për çdo lloj sugjerimi sepse në fund të fundit nuk e bëj unë listëprezencën e bëni ju dh e keni ju kontaktin me prindërit. Çfarë të jetë e drejtë e thjeshtë normale për të ndodhur dhe që t'ua lehtësoj punën edhe prindërve por edhe ju se vështirësia më e madhe është tek edukatorët që kanë kontakt me gjithë prindërit janë 100% në dizpozicion Drejtori, Bashkia çfarë ju mungon e kërkoni e zgjidhni.
-Znj Eueda Molla - Nënkryetare në Bashkinë Lezhë- Po Alfrida?
-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Faleminderit! Kush nuk më njeh jam Alfrida Marku pjesë e Këshillit Bashkiak, në fakt ne shpesh mësuesve dhe edukatoreve ju kërkojmë të mos përdorin telefonin kurse këtu po ju thojmë PO për të bëre listëprezencën të cilën me ose pa arsye. Ky është një detaj që ju duhet ta rishikoni. Sot, gjatë degjesës publike mbi nismën e Bashkisë Lezhë për rritjen e tarifës së kopështeve, po shpreh argumentet e mija kundër kësaj rritjeje. Nga ajo që kuptova unë ju tashmë e keni bërë fakt të kryer projekt – vendim. Unë e shoh vendimarrje të ezauruar sepse këtu nuk u shtrua diskutimi se si mendoni ju për rritjen e kësaj tarife, por u bë fakt i kryer se tarifa do rritet, por po ju parashtrojmë sesi do të bëhet mbledhja e të ardhurave për Bashkin.
Personalisht e konsideroj të nxituar, të panevojshme, jo proporcionale në raport me teresinë e kushteve si dhe një barrë shtesë për ekonominë e shumë familjeve.
Në kushtet kur Bashkia Lezhë deklaron stabilitet financiar, fëmijet dhe mbështetja ndaj familjeve duhet të jenë prioritet.

Pavarësisht përmirësimeve në infrastrukture, sot, grupet në kopshtet e çerdhen e qytetit të Lezhes, vijojnë të kenë 35 deri 40 fëmijë. Ndikuar kjo edhe nga numri i lartë i kërkesave nga njësitë administrative. Një shqetësim të adresuar nga shumë prindër në këtë fillim viti arsimor në lidhje me mjetet didaktike e edukative në kopështe: në kushtet kur furnizimi nga Bashkia Lezhë nuk është i plotë, si një ndër detyrimet e këtij institucioni, në pjesën më të madhe prindërit duhet t'i sigurojnë vetë këto mjete duke kontribuar çdo vit për blerjen e tyre. Kjo situatë, vendos edukatorët në një pozite të vështire e jo të drejte, si dhe është një rëndesë në ekonominë e secilës familje.

Për këtë arsye, ju kërkoj përfaqësuesve të Bashkisë Lezhë marrjen e përgjegjësive për shmangien e kësaj praktike si dhe përmbushjen e detyrimit për furnizimin e plotë të kopshteve me mjete didaktike e mësimore. Kopshtet dhe çerdhet publike të menaxhuara nga Bashkia duhet të jenë zgjidhje, lehtësi e jo rëndesë që shtohet për familjet e Lezhës. Edukatoret dhe stafi mbështetës në kopshte e çerdhe duhen mbështetur maksimalisht për punën e palodhur e përkushtimin e tyre të përditshme.

Ju keni shprehur këtu se përgjysmohet tarifa për disa në nevojë, unë mendoj se duhet përjashtru. Nese ne kemi një fëmijë familja e të cilit trajtohet me ndihmë ekonomike, nëse kemi një fëmije që babai tij ka ndërru jetë nëna e tyre kryefamiljare, është e divorcuar cfarë tarife duhet ti merret për kopshte-çerdhe asaj nëne që janë element që duhen rishikuar .Çdo gjë do ishte përmiresuar nëse do kishit shkuar në kopshte dhe çerdhe të bënit takime me prinderit.

-Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Drejtoria paguhet për materialet didaktike vetjake, as kopshtet dhe as shkollat ne të gjithë blejmë lapsa stilolapsa, letra për fëmijë. Ju nuk paguani për lojrat kolektive dhe për të gjitha materialet didaktike që përdoren për fëmijët tuaj.

-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Bashkia nuk i mbulon në mënyrë të mjaftueshme, me numëru fëmijet se sa frekuentojnë Kopshtet i numërojmë shumë mirë 570, me përllogarit sa materiale edukative duhen për 570 fëmijë, dhe kështu i vendosim në një pozitë jo të mirë edukatoret. Unë do e diskutoj dhe në Këshill Bashkiak, janë shuma të konsidorueshme për të cilat Bashkia me një buxhet 30 miliard leke mundet me marr përgjegjësi.

- Znj Aurora Gjeloshi –Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Detaji i parë që mbajta shënim është që kjo dëgjes publike bëhet në formë urdhëri. Ne kemi detyrim të sqarojmë se pse kemi ardhur tek ky projekt vendim dhe pse ne mendojmë se kjo gjë duhet të ndodh kshu. Projekt vendimi nuk vendoset në Drejtori dhe me një shkresë të brendshme të Kryetarit të Bashkisë. Projekt vendimi vendoset në Këshillin Bashkiak. Nëse do të votohet nga të gjithë, do të kaloje, nëse jo, do ri-ndryshohet me komentet që po marrim sot. Mënyra sesi ne sqarojmë dhe nëse ka paqartësi do i sqarojmë prap. Ju duhet ta keni më të qartë se të gjithë ne sepse jeni përfaqesuese e Këshillit Bashkiak, që do të thotë ju e keni në dorë ta vendosni apo jo. Ne kemi detyrime të sqarojmë pse kemi ardhur ktu.

-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Ne diskutojmë se cfarë na vjen në Këshill nga ju.

- Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve-Dakort pra, kjo eshte nje projekt vendim dhe po bejme mbledhje per te sqaruar arsyet pse. Kjo nuk esht nje urdher qe keshtu do ndodhi.

-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Ne keshill duhet te vije nje product gjeresisht I konsultum dhe per sa fola me lart kerkoj vemendjen e bashkise per te garantu materialet baze didaktike.

- Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Ne gjykojmë se është e drejtë të ndodh kështu, e para duke u konsultuar edhe me përpara me grupe më të vogla por jo kaq zyrtare, e dyta duke mbledhur gjithë shqetësimet që kanë edukatorët apo drejtuesit, prindërit dhe gjithë stafi. Dhe duke u konsultuar me pjesën buxhetore sepse siç e dim dhe besoj edhe ju më mirë se të gjithë ne, tarifat edhe bazuar në ligj duhet te mblidhem. Pra t'i vendos një tarifë, të cilën duhet ta mbledhësh. Nëse unë duhet të shpenzoj më shumë lekë për shkak të shtimit të kërkesës, e cila thamë se vjen për shkak të investimit të Bashkisë por edhe interes të vazhdushme në rritje sepse kushtet dhe shërbimi është i lartë, atëherë unë këtë tarifë do duhet ta rris për të perballuar këtë shpenzim që kam. Për këtë arsye duhet të jem në propocion të drejtë. Për sa i përket propocionit të drejtë në rritje me pagat është i njëjti koment që i dhash zotërisë, pagat prap janë rritur këtë vit, dhe ky është një diksutim që gjithsesi nuk bëhet në nivelin tonë. Përsa i përket ndihmës që edukatorët duhet të kenë sidomos për fëmijët që janë me aftësi ndryshe apo problematik, ky është tu një problem shumë më i thellë se mbledhja e sotme, ndoshta nuk duhet ta trajtojmë por unë kam detyrimin të them se vetëm 10% e të gjithë fëmijëve që kanë aftësi ndryshe apo shfaqin zhvillim pak me ndryshe se fëmijët e tjerë, janë sot të deklaruar me letra zyrtare, pra janë me AK. Të gjithë fëmijët e tjerë të cilët prindërit nuk i kanë deklaruar ose nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm, na lënë komplet të paaftë që ne të sigurojmë ndihmë profesionale sepse unë nuk mund të kërkoje në Ministri një mesues specifik për këtë fëmijë kur vetë prindëri nuk e pranon që fëmija i vetë ka nevojë për ndihmë. Çfarë do të thotë që unë i lutem dhe stafit tim psikologës apo edukatoreve dhe Drejtoreshave, të ngrejnë komisione që ne ti evidentojmë këto fëmijë. Në fund të fundit ligji shqiptare nuk na ndihmon sepse është prindi ai që firmos për zhvillimin e fëmijës së vet. Është vërtetë shumë problem. Në nuk mund ti evitojmë dhe nuk mund të mos i përfshijmë. Përsa i përket mjeteve didaktike Bashkia ka një fond mbi 10 milion lekë që shpenzon çdo vit, për mjete didaktike të përbashkëta. Bashkia nuk pagun për lapsa, stilolapsa që do t'i duhet fëmijës, ashtu siç nuk paguan për lapsa, stilolapsa shkolla as Ministria. për fëmijët në nevojë është Drejtoria e Shërbimit Social.

-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Një pyetje. Ku e gjeni bazën ligjore që prindërit të paguajn për mjetet didaktike.

- Znj Aurora Gjeloshi–Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Nuk ka bazë ligjore që t'i përmbahesh. është një listë me produkte e cila nuk është e detyrushme. Pra nëse ka prind që nuk e perballon dot, nuk e përballon. Ne kemi vite që e kemi lënë fakultative por ajo që ndodh është.

-Znj Alfrida Marku-Pjese e Keshillit Bashkik Lezhe- Nuk e bën dot facultative.

- Znj Aurora Gjeloshi-Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- Nuk e bën dot pra. Në këtë moment që ne dhe kopshtet e mbledhin vetë do të thotë që ke 30 lapsa njësoj, të gjithë fëmijët të ndjehen njësoj. Ai është konsum personal i një fëmije. Nëse nuk e përballon blerjen është Drejtoria e Shërbimeve Sociale. Patjetër që duhet të ishin përjashtuar të gjithë fëmijët që duhet të plotësojn dokumentat ligjore për ndihmë sociale. Të gjitha këto menaxhohen nga Shërbimet Sociale. Është Drejtoria e Shërbimeve Sociale që na i sjellin ne dhe ne i akomodojmë pa pagesë. Unë e kam parashikuar 50% për fëmijët që vjen tek unë drejtëpërdrejtë. Pra një familje që nuk i plotëson kushtet për të marr asistenc sociale apo për t'u trajtuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, të cilët trajtohen atje dhe vijnë pa pagesë, fëmijet e tjerë të cilët i kanë kushtet por gjithsesi nuk i kanë kushtet e barabarta me pjesën tjetër duhet të paguajn 50%. Ata që duhet të jenë me 100% kalojnë tek Drejtoria e Shërbimeve Sociale, nuk vijn tek Drejtoria e Arsimit. Dhe jemi në përgjegjës me Drejtorin e Shërbimeve Sociale

për t'i akomoduar. Kemi shumë fëmijë nga këto nëse ju duhen shifrat jua gjejmë dhe jua japim.
-Znj Denisa Nikolli-Psikologe- Të gjithë fëmijët që vijnë nga Shërbimi Social janë të përjashtuar nga tarifa 100%.
- Kritina Marku-edukatore kopshti beslidhja- Faktikisht më e mira do ishte që sot të ishin me shumë prindër.
- Znj Aurora Gjeloshi- Bashkia e ka postuar në të gjitha web-et. Jeni ju edukatoret që keni konkat të drejtëpërdrejtë me prindërit për t'i njoftuar.
-Prindi nr 3 – Jam banorë i Lagjes Gurra, kam patur vajzën në këtë kopsht, tani kam djalin, dhe jam shumë i kënaqur me këtë kopsht. Nuk kam asnjë vrejtje. Jam dakort plotesisht me ju.
- Prind nr 4- Unë jam prind i kopshtit Hirushja. Nuk kam asnjëllojë vërejtje. Thjesht dua të shtoj diçka. Nëse grupet kanë më shumë sesa dy fëmijë me aftësi ndryshe, pse të mos ketë një mësues ndoshta dhe me gjysëm rroge sepse është vetem pjesen e parë të ditës.
-Znj Eueda Molla - Nënkryetare në Bashkinë Lezhë- kemi nje problem sepse nuk arrijm në shtimin e stafit gjatë gjithë kohës ndërkohë që ne nuk e kemi me fakte sepse vetem në kopshtet e qytetit vetem 5 femije janë me dokumenta dhe në momentin që unë nuk e justifikoj dot mesuesin ndihmes aty, nuk e marr dot. Ne kemi pasur raste qe kemi hasur në vështirësi dhe me prinderit sepse bashkia ka dërgu grupin per ta verifiku, kontrollin me ZVA-n , me Drejtorine e Arsimit dhe Psikologun, kemi hasur vështirësi me prinderit sepse na kanë thënë "Çpun ke ti që vjen tek femija im qe ta kontrrollosh, ka instance te tjera qe e kontrollojne".
- Znj Aurora Gjeloshi - Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve- me përpara une kam dijeni që është bërë tentative për të punesuar mesues ndihmës por nuk ka pasur kerkesa me arsim special për keto femije. Ajo që jemi munduar ne të bëjmë bashkë me Drejtoreshat është të bëjmë një rishperndarje të këtyre fëmijeve në grupe por kemi nje problem sepse nese kemi 4 fëmijë 3 vjec dhe ke nje grup me femije 6 vjec pa asnje femije me problem, kete 3 vjecarin nuk e con dot ne grupin 6 vjec.
A kemi komente te tjera?
Nese jo, Faleminderit të gjithëve , ditë të mbarë.

Për

Drejtorinë e Arsimit ,Rinisë dhe Sporteve

Denisa Nikolli

Për

Këshillin Bashkiak Lezhë

Florida Çunaj















